

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ana e SKion GmbH, Seedammweg 55, 61352 Bad Homburg v.d. Hohe, Republika Federale e Gjermanisë, të dorëzuar përmes Vllado Ilievskit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026, solli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi i cili i referohet fitimit të kontrollit të plotë mbi pjesën thelbësore të biznesit të vazhdueshëm përmes blerjes së aseteve dhe aksioneve në filiale të caktuara të BMZ Holding GmbH, Zeçe Gustav nr. 1 Karlstein 63791, Gjermani nga ana e SKion GmbH, Seedammweg 55, 61352 Bad Homburg v.d. Hohe, Republika Federale e Gjermanisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për inicimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 10.02.2026, dhe i plotësuar më 24.02.2026, 25.02.2026 dhe më 26.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim, i cili i referohet fitimit të kontrollit të plotë mbi pjesën thelbësore të biznesit të vazhdueshëm përmes blerjes së aseteve dhe aksioneve në filiale të caktuara të BMZ Holding GmbH, Zeçe Gustav nr. 1 Karlstein 63791, Gjermani nga ana e SKion GmbH, Seedammweg 55, 61352 Bad Homburg v.d. Hohe, Republika Federale e Gjermanisë.

Gjegjësisht, në transaksion SKion GmbH do të marrë një pjesë vendimtare në filialet e mëposhtme të BMZ Holding GmbH:

- Visatronic GmbH, e regjistruar në gjykatën lokale Offenbach nën HRB 40463 - me seli në Dieselstr. 19, 63533 Mainhausen, Gjermani, 100% të kapitalit aksionar;

- Batteryuniversity GmbH, e regjistruar në gjykatën lokale Aschaffenburg nën HRB 10299 - dhe seli në Am Sportplatz 30, 63791, Karlstein, Gjermani, 100% të kapitalit aksionar;
- KION Battery Systems GmbH, e regjistruar në gjykatën lokale Aschaffenburg nën HRB 15392, me seli në Zeche Gustav 1, 63791 Karlstein, Gjermani - 50% të kapitalit aksionar;
- BMZ Company Limited Kinë - e regjistruar në Administratën për Rregullimin e Tregut Shenzhen me seli në Ndërtesën B, Ndërtesa Yulong Technologies, ana jugperëndimore e udhëkryqit të Rrugës së 1-rë Baolong dhe rrugës Chengxin, nën-qarku Baolong, qarku Longgang, Shenzhen, Kinë, 100% të kapitalit aksionar;
- BMZ Hong Kong Limited - Hong Kong, Regjistri i Kompanive Hong Kong me seli në adresën 19H Maxgrand plaza nr. 3, Tai Yau Street, San Po Kong, Kowloon, 100% të kapitalit aksionar;
- BMZ Poland Sp.z.o.o. Poloni, me seli në Gliwice, rr. Albert Einstein 9, 44-109 Gliwice, Poloni, e regjistruar në Gjykatën e Qarkut Gliwice nën KRS nr. 0000353823, 100% të kapitalit të kompanisë;
- BMZ USA Inc., SHBA, Virxhinia, - me seli në 1429 Miller Store Road, Virginia beach VA 23455, 100% të kapitalit aksionar;
- BMZ Japan KK, Japoni, e regjistruar në Byronë për Çështje Juridike në Tokio nën numrin 0300-01-119624 - me seli në Shitaya 1-6-5, Taito-ku, Tokio, Japoni, 100% të kapitalit aksionar;
- BMZ SHPKNJP Ilinden Shkup, numri amë 7688253, me seli në adresën 106, blloku 5 - ZZHTI Shkup, Bunarxhik, Ilinden, R. e Maqedonisë së Veriut, - 100% të pjesës;
- BMZ Innovation Group LTD, Angli dhe Uells, numri 13074246 me seli në adresën Future Business Centre, Kings Hedges Road, Cambridge CB4 2HY, Mbretëria e Bashkuar, 100% të kapitalit aksionar; dhe
- BMZ Brasil, Desenvolvimento, Produção e Serviços de Manutenção de Sistemas de Armazenamento de energia, e regjistruar nën nr. 55.061.712/0001-02- në Regjistrin Brazilian të Tatimpaguesve të Korporatave me seli në Rua Rocha, Pombo, No. 2561, Warehouse, Brazil, 100% të kapitalit aksionar.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimet dhe shtojcat e tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

SKion GmbH përmes dy filialeve indirekte në pronësi të plotë (SKion Beteiligungs GmbH dhe SNV Operations GmbH) do të fitojë kontroll të plotë mbi pjesën thelbësore të biznesit ekzistues të BMZ Holding GmbH dhe filialeve të saj, të cilat së bashku përfaqësojnë Grupin BMZ përmes blerjes së aksioneve dhe asetëve (në tekstin e mëtejshëm: Biznesi i synuar i BMZ - **BMZ Target Business**).

Veprimtaria e SKion GmbH është blerja, zotërimi dhe menaxhimi i pjesëve (aksioneve) në kompani të tjera, si dhe menaxhimi i asetëve të veta, pa transaksione që i nënshtrohen mbikëqyrjes në kuptim të Ligjit për Bankat ose Ligjit për Institucionet e Letrave me Vlerë.

SKion GmbH është një kompani holding, në pronësi të anëtarëve të caktuar të familjes Klatten, e cila zotëron dhe menaxhon aksione në kompani dhe menaxhon asetet e saj. SKion aktualisht mban 50% ose më shumë në filialet e mëposhtme:

- ALTANA AG (100%), një furnizues global i kimikateve speciale për prodhuesit e veshjeve, konvertuesit e plastikës, industrinë e printimit dhe paketimit, industrinë kozmetike dhe industrinë elektrike.
- SKion Water GmbH (100%), një furnizues global i teknologjisë së ujit dhe ujërave të zeza që ofron zgjidhje për trajtimin e ujit dhe ujërave të zeza për vendbanime dhe konsumatorë industrialë dhe komercialë të ujit, si dhe zhvillon e zbaton teknologji përkatëse inovative.
- AVISTA OIL AG (50%), një kompani aktive në asgjësimin dhe përpunimin e vajrave të mbeturinave dhe lëngjeve që përmbajnë vajra për prodhimin e vajrave bazë dhe lubrifikantëve.

Në vitin 2024, SKion GmbH ka realizuar të hyra në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga shitjet e ALTANA AG, e cila është në pronësi të plotë, që është një furnizues global i kimikateve speciale për prodhuesit e ambalazheve, konvertuesit e plastikës, për industrinë e printimit dhe paketimit, industrinë kozmetike dhe atë elektrike, pa asnjë lidhje me tregun e baterive.

Veprimtaria e BMZ Holding GmbH është menaxhimi i asetëve të veta, shitja, zotërimi i pjesëmarrjeve dhe menaxhimi i kompanive holding në Gjermani dhe jashtë vendit, qëllimi i të cilave është veçanërisht importi dhe eksporti, tregtia dhe prodhimi masiv i produkteve elektrike në nivel fabrike, veçanërisht baterive, përgatitja e ekspertizave dhe kryerja e testimeve, trajnimeve dhe konsulencës në fushën e teknologjisë së baterive.

Biznesi i synuar i BMZ është aktiv në prodhimin dhe shpërndarjen e moduleve dhe sistemeve të baterive për një gamë të gjerë aplikimesh në e-mobilitet, sistemet e vozitjes, ruajtjen e energjisë, mjetet e energjisë & kopshtarisë, mjekësore dhe industriale. Aplikimet variojnë nga

automjetet elektrike, pirunët ngritës, e-biçikletat, pajisjet për ruajtjen e energjisë, pajisjet e lëvizshme mjekësore, pajisjet elektrike si prerëset, sharrat, trapanët/turjelat dhe kaçavidat pa tel. Biznesi i synuar i BMZ nuk prodhon bateri, por përpunon qelizat e blera të baterive në module dhe sisteme baterish (të njohura si pako baterish) me sisteme kontrolli dhe karikimi. Modulet dhe sistemet e baterive të prodhuara nga biznesi i synuar i BMZ u shiten pothuajse ekskluzivisht klientëve komercialë.

Me transaksionin në fjalë, SKion GmbH do të fitojë kontrollin edhe mbi BMZ SHPKNJP Ilinden, Shkup, Maqedonia e Veriut me seli në "106" Nr. BLOKU 5 - ZZHTI / SHKUP 2 BUNARXHIK, ILINDEN, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari - prodhimin e baterive dhe akumulatorëve.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ